

# Letër për prindërit

## Dy- dhe shumëgjuhëshmëria

*„Si i mëson fëmija im dy apo më shumë gjuhë?“*

Informacione dhe këshilla për mbështetjen e gjuhës



© Martina Furlan

**A6 - Bildung und Gesellschaft**  
Referat Kinderbildung und -betreuung  
Pädagogische Qualitätsentwicklung  
Frühe Sprachförderung

## Të dashur prindër, të dashur kujdestarë ligjorë,

gjuha e folur në shoqërinë tonë është thesar i çmuar. Fëmiju i juaj gjatë zhvillimit është në kontakt me gjuhë dhe kultura të ndryshme. Andaj është e rëndësishme që kjo shumëllojshmëri të shfrytëzohet në mënyrë pozitive për të krijuar një bazë optimale për një zhvillim të mëtejshëm. Gjuha e cila flitet në familjen tuaj si gjuhë e parë (gjuha e zemrës) ka një vlerë të veçantë. Më anë të saj shprehen ndjenjat dhe nevojat individuale në mënyrë autentike.

Ne dëshirojmë t'ju japim disa informacione dhe këshilla lidhur me mbështjetjen gjuhësore.

## Çfarë i nevojitet fëmijut tim që gjuha e tij të zhvillohet mirë?

Nëse fëmija juaj rritet me dy gjuhë të ndryshme, si p.sh. në shtëpi me gjuhën e familjes dhe në institucionin arsimor dhe të kujdesit fillor të fëmijëve (foshnjore, kopshti i fëmijëve, shtëpinë e fëmijëve,...) me gjermanishten, kjo hap një mundësi të madhe për të ardhmen e mëtejshme të fëmijës tuaj. Hetime dhe studime të ndryshme kanë treguar që përvetësimi i gjuhëve të shumta për fëmijë është i menaxhueshëm.

### Institucioni arsimor dhe ai i kujdesit fillor të shihet si burim pozitiv:

Gjuhët mësohen edhe më lehtë, nëse fëmijët hyjnë sa më herët në kontakt me gjuhën në formë të lojës dhe në mënyrë të padetyruar. Në qendrën e edukimit, personeli i specializuar pedagogjik qëllimisht promovon gjuhën gjermane duke luajtur, me anë të bisedave, me anë të këngëve dhe vargjeve, të librave me fotografi si dhe me anë të tregimeve. Fëmijës këtu i jepet mundësia që t'a mësojë gjuhën pa presion dhe detyrim dhe për më tepër të ketë kontakte sociale. Ardhja e rregullt në institucionin e arsimit dhe kujdesit të fëmijëve ka një efekt të dobishëm në zhvillimin gjuhësor të fëmijës tuaj.

Kontaktet sociale (kontakti me fëmijët e tjerë, takimet për të luajtur, apo lojërat në grupe etj.) nxisin gjithashtu interaksionin gjuhësor.

### Gjuha e parë (gjuha e familjes) të vështrohet si burim pozitiv:

Një person do të duhet të flasë vetëm një gjuhë me fëmijën. Për këtë arsye ky rregull quhet edhe „rregulli 1 dhe 1“ (1 person - 1 gjuhë) Në këtë mënyrë fëmijët mund t'i dallojnë gjuhët të cilat fliten në familje dhe në rrethin social dhe kështu mund t'i mësojnë më së miri. Duhet të merret parasysh se nuk duhet të flitet në dy gjuhë të ndryshme!

Sigurisht se ky rregull mund të thyhet herë pas here për të mënjanuar problemet në komunikim, por sa më shume që t'i përmbaheni, aq më lehtë është për fëmijët t'i dallojnë gjuhët nga njëra tjetra.

# Ide praktike dhe këshilla për zbatim në familje

Gjuha është thelbësore dhe e rëndësishme, jo vetëm në institucionet e arsimit dhe të kujdesit të fëmijëve, por edhe në jetën e përditshme të familjes.

## Gjuha është kudo

Aftësitë gjuhësore të fëmijës suaj rriten dita ditës dhe përvehtësohen nëpërmjet dëgjimit aktiv dhe vetë të folurit. Integrojeni fëmijën tuaj në aktivitetet e përditshme (p. sh. tek zierja së bashku, blerja etj.) dhe shoqërojeni më anë te gjuhës.

Bisedat e përditshme me fëmijën tuaj janë tejet të rëndësishme:

*Tregoni fëmijës suaj për*  
*...punën tuaj*  
*...një ngjarje/përjetim të shkurtër*  
*...planin ditor*  
*...ndjenjat tuaja.*

*Ka situata dhe momente të panumërta në të cilat ju fëmijën tuaj mund t'a shoqëroni me anë të gjuhës. Dhuroni edhe ju fëmijës suaj kohë që ai të tregojë rreth përjetimeve të tija në përditshmëri:*

*„Si ishte sot në kopsht?“*  
*„Çfarë keni ngrënë sot në mëngjes?“*  
*„Me çfarë ke luajtur sot në kopsht?“*  
*„Keni kënduar përsëri një këngë në kopsht?“ Ke dëshirë ta këndosh për mua?“*  
*„Si ishte festa e ditëlindjes së Simonit?“*

Duke treguar tregimin, fëmija gradualisht mëson të shprehet më mirë dhe mund të shpjegojë idetë dhe dëshirat e tij me fjalët e duhura.

## Këshillë praktike:

Përdorni „Feedback korrigjues“. Kjo do të thotë që gabimet gjuhësore të fëmijës nuk duhet të korrigjohen direkt, por përkundrazi fjalia e folur duhet të përsëritet në mënyrë korrekte. Kështu fëmija e dëgjon fjalinë e saktë të cilën me kalimin e kohës e ngulit në kujtesë.

## Shikoni librat së bashku

Librat për fëmijë përmbajnë informacione, nxisin për të menduar dhe diskutuar, adresojnë ndjenjat dhe e promovojnë imagjinatën dhe kreativitetin. Krahas kësaj fëmija mëson aftësi të rëndësishme, të cilat janë të rëndësishme për hyrjen në shkollë.

Gjate vëzhgimit dhe leximit është e rëndësishme:

- që fëmija dhe i rrituri të kënaqen
- që fëmija juaj mund t'i shpreh përshtypjet e tija (vëzhgimet) mbi fotografi dhe përmbajtjet e tregimeve.

Ne raste të tilla bëhet fjalë për vështrim të librit me fotografi në formë të dialogut.

#### Këshilla praktike:

Librat me fotografi në gjuhën gjermane, që nuk kanë ose kanë vetëm pak tekst, janë të përshtatshme për t'i parë fotografi me fëmijën tuaj dhe për t'i përshkruar ato në gjuhën tuaj të parë (si p.sh. të ashtuquajturat „Wimmelbücher“). Librat me fotografi mund t'i huazoni në biblioteka dhe në kopshte të fëmijëve. Përveç kësaj Styria (Land Steiermark) gjithashtu ofron një platformë me shumë sugjerime për libra.

Këngët, lojërat me gishta dhe vjershat janë gjithashtu shumë të rëndësishme për zhvillimin e aftësive gjuhësore. Ato i argëtojnë fëmijët dhe njëkohësisht në mënyre jokoshiente (nën vetëdije) i promovojnë aftësitë e fëmijës tuaj.

### Mediat digjitale nuk e zëvendësojnë gjuhën e folur!

Konsumimi i tepruar (televizioni, videot dhe tabletet, Smartphone-at, ...) nuk ushtrojnë aftësitë gjuhësore të fëmijës suaj. Fëmijët mësojnë shumë më tepër përmes bisedave të drejtpërdrejta me ju dhe të tjerët.

**„Gjuha është çelësi i botes“**

Wilhelm von Humboldt

#### Burimi:

Boeckmann, Klaus-Börge/ Lins, Sabina/ Orlovsky, Sarah/ Wondraczek, Ines (2011): Mehrsprachigkeit in den Kindergärten. Methodisches Handbuch für die Sprachvermittlung. Wien: Amt der Niederösterreichischen Landesregierung/ Regionaler Entwicklungsverband Industrieviertel-Projektmanagement.

Ulich, Michaela (k.A.): Wie lernt mein Kind 2 Sprachen, Deutsch und die Familiensprache? München: Staatsinstitut für Frühpädagogik-IFP München. Online verfügbar unter: [https://www.ifp.bayern.de/imperia/md/content/stmas/ifp/elternbrief\\_deutsch.pdf](https://www.ifp.bayern.de/imperia/md/content/stmas/ifp/elternbrief_deutsch.pdf) [17.7.2020].

Charlotte Bühler Institut im Auftrag der Ämter der Landesregierungen der österreichischen Bundesländer, Magistrat der Stadt Wien & Unterrichtsministerium für Unterricht, Kunst und Kultur (2009a): Bildungsplan-Anteil zur sprachlichen Förderung in elementaren Bildungseinrichtungen. Aktualisierte Version. Wien: BMUKK

